



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 67
Prishtinë, më 22 qershor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 22 QERSHOR 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë dhe i deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare.

Ai procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Salih Morina, Afrim Kasolli, Ramiz Kelmendi, Rada Trajkoviq, Nijazi Idrizi, Vjosa Osmani, Albana Gashi, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi, Hashim Deshishku, Lirije Kajtazi, Ismet Beqiri, si dhe ministrat: Besim Beqaj, Nenad Rashiq e Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Albulena Haxhiu, parashtrroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi, në lidhje me hartimin e Projektligjit për Amnisti.

Ministri Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Në pyetjen e radhitur për mbledhjen e sotme plenare, (numri i pyetjes DO-1078), të deputetes Nazane Breca për ministrin Ferid Aganin, ajo konstatoi se ka marr përgjigje.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtrroi pyetje për ministrin Hajredin Kuçi, në lidhje me atë se me çfarë baze ligjore keni urdhëruar një vizitë të zv.ministrit të Financave , Astrit Haraçia që ta vizitojë në Burgun e Dubravës, Ilir Tolajn, i cili gjithashtu akuzohet për korrupsion gjatë kohës sa ishte sekretar i përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë.

Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi iu përgjigj pyetjes së deputetes Albulena Haxhiu.

Deputeti Burim Ramadani parashtrroi pyetje për ministrin Bajram Rexhepi, në lidhje me ekzistimin apo jo të një plani konkret për fuqizimin e kapaciteteve të Policisë së Kosovës dhe të njësisë gjegjëse për inteligjencën financiare, për hetimin e rasteve komplekse të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë shpëlarjen e parave dhe krimin ekonomik.

Ministri Bajram Rexhepi iu përgjigj pyetjes së deputetit Burim Ramadani.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 14 qershor 2012

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 14 qershor 2012.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Ministri i Drejtësisë, **Hajredin Kuçi** tha se nevoja për miratimin e projektligjit konsiston në vazhdimin e forcimit të institucioneve vendore për t'i dhënë fund mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, e cila do t'i mundësonte vendit tonë që të zërë vendin e vet meritore në mesin e shteteve të pavarura të botës.

Në vazhdim, ministri Kuçi theksoi se në këtë projektligj parashihet plotësimi dhe ndryshimi i dispozitave përkatëse të ligjeve që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, ndërsa më pas u fokusua në 21 ligjet të cilat pritet t'i ndryshojë ky projektligj.

Projektligji nuk krijon shpenzime shtesë për buxhetin e Republikës së Kosovës, theksoi ai.

Në fund, ministri Kuçi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arsim Bajrami - në emër të Komisionit ad-hoc për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Behar Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Vjosa Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Burim Ramadani - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Rasim Demiri - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Sabri Hamiti, Hydajet Hyseni, Skënder Hyseni, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa, Goran Marinković, Rexhep Selimi, Liburn Aliu, Afrim Kasolli, Albulena Haxhiu, Albana Gashi, Arsim Bajrami dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 78,
Kundër----- 10,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi, në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës që ta shqyrtojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektkodit të Procedurës Penale

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqes dhe arsyetojë Projektkodin e procedurës penale.

Ministri i Drejtësisë, **Hajredin Kuçi** tha se qëllimi i këtij projektkodi është eliminimi i zbrastësirave të cilat hasen në Kodin e Procedurës Penale i cili është në fuqi.

Në vazhdim theksoi me ndryshimin e rrethanave politike, ekonomike, dhe të statusit të Republikës së Kosovës, është e nevojshme që edhe Kodi i Procedurës Penale të ndryshohet.

Në përpilimin e projektkodit janë marrë parasysh komentet dhe sugjerimet e aktorëve relevant me qëllim të gjetjes së kompromisit për të gjitha palët, duke pasur si prioritet dy çështje kryesore: procedurën më efikase dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Më pas ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektkodi i cili përbëhet prej 549 neneve të ndara në 6 pjesë dhe 38 kapituj.

Në fund, ministri Kuçi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektkodin e procedurës penale.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim të Projektkodit të Procedurës Penale.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Behar Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” Burim Ramadani - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sasha Milosavljeviq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektkodin e Procedurës Penale.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi, në parim Projektkodin e Procedurës Penale.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektkodin e Procedurës Penale, brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i vendimit të presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës për rishqyrtim

Kryesuesi, **Sabri Hamiti** i njoftoi deputetët se Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar vendimin e Presidentes së Kosovës për kthim në Kuvend të neneve 37 dhe 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Raportin e Komisionit për Legjislacion e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, deputeti Arben Gashi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Berat Buzhala - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arben Gashi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Burim Ramadani - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani – në emër të GP të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Fikrim Damka - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Arsim Bajrami, Behar Selimi, Adem Grabovci, Daut Haradinaj, Halit Krasniqi dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentin e propozuar nga Komisioni Funkcional për Legjislacion.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi nuk e miratoi amendamentin e Komisionit për Legjislacion, sipas vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës, për kthimin në rishqyrtim të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082.
2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. 04/L-082, konsiderohet i shpallur ashtu siç ka qenë i miratuar nga Kuvendi, në mbledhjen plenare të mbajtur me datë 20 prill 2012.

7. Shqyrtimi i raportit të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, për vitin 2011

Deputeti Idriz Vehapi, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, e arsyetoi Raportin e Punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, për vitin 2011. Ai tha se Komisioni e përkrah këtë raport dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj – në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Xhevahire Izmaqi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lirije Kajtazi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Afrim Kasolli - në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes "Vetëvendosje", Teuta Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Jeton Svirca - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Mufera Shinik - në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe Lutfi Haziri, Salih Morina dhe Safete Hadergjonaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi Sabri Hamiti, për mungesë të kuorumit, deklaroi se votimi i këtij raporti do të bëhet në mbledhjen plenare të radhës.

Kryesuesi i deklaroi të mbyllur punimet e mbledhjes plenare në orën 14:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale